



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura IV

Sesioni pranveror

Komisioni për Legjislacion

Mbledhja nr. 79

Prishtinë, më 27 maj 2013, në orën 12:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla S 2

PROCESVERBAL

I mbledhjes së Komisionit për Legjislacion

Në mbledhje morën pjesë: Arben Gashi, Mufera Shinik, Ardian Gjini, Halit Krasniqi, Gëzim Kelmendi, Arsim Bajrami, Albulena Haxhiu, Armend Zemaj dhe Jasmina Zhivković.

Munguan: Behar Selimi dhe Haki Demolli.

Të ftuar dhe pjesëmarrës të tjerë: Alban Sutaj dhe Drita Rexhepi – ANJF; Andi Shehu, Blerim Morina, Valbona Zymberi, Vjollca Saraqi, Besarta Tahiri dhe Zylkyfli Preniqi – AAB; Besnik Ramadani KDI; Visar Smajlaj – ekspert, Lumnije Murati – ZPRK; Fehmi Pireva – Kuvendi Kosovës; Petrit Hysaj dhe Lejla Selimi – OSBE.

Nga Stafi i Komisionit për Legjislacion: Idriz Tahiri, Fehmi Hyseni dhe Visar Krasniqi.

Mbledhjen e kryesoi, Arben Gashi , kryetar i Komisionit.

Rendi i ditës:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Shqyrtimi i raportit vjetor të punës së Agjencisë për Ndihmë Juridike Falas, për vitin 2012;
3. Shqyrtimi i propozim- amendamenteve të grupit punues në Projektligjin për ekzekutimin e sanksioneve penale;
4. Shqyrtimi i raportit të Komisionit për Buxhet dhe Financa, lidhur me vendimin e presidentes së Republikës së Kosovës për kthimin e Ligjit nr. 04/L-163 për mallrat e liruara nga tatimi doganor dhe mallrat me tarifë zero të tatimit doganor;
5. Shqyrtimi i raportit plotësues të Komisionit për Buxhet dhe Financa në Projektligjin nr. 04/L-185 për tarifat e veçanta të akcizës për prodhimin fillestar dhe prodhimeve të produkteve alkoolike të prodhuara në Kosovë;
6. Të ndryshme.

1. Miratimi i rendit të ditës

Kryetari, propozoi që në rend dite të radhiten edhe: mandati i anëtarëve të Këshillit Gjyqësor të Kosovës dhe Agjencisë Kosovare të Pronës, si dhe monitorimi i Ligjit nr. 03/I- 159 për Agjencinë kundër Korrupsionit. Propozoi që pika e dytë të hiqet nga rendi ditës, sepse Agjencia ka adresuar një kërkesë për mbështetjen dhe qëndrueshmërinë e zyrave për ndihmë juridike falas. Këtë material e kemi marrë me vonesë, po ashtu edhe me një arsye shtesë është që Komisioni për Mbikëqyrjen e Financave Publike nuk e ka shqyrtuar këtë raport, sepse ka mospërputhje financiare.

Albulena Haxhiu, propozoi që kur të debatohet për monitorimin e Ligjit për Agjencinë kundër Korrupsionit, të kërkojmë edhe formularët e deklarimit të pasurisë për zyrtarët e Agjencisë.

Armend Zemaj, ishte i mendimit që raporti mund të shqyrtohet, pa marrë parasysh arsyet që kryetari përmendi.

Ardian Gjini, u pajtua që raporti të hiqet nga rendi ditës, por ngriti shqetësimin e tij rreth librave-informatorëve që Agjencia për Ndihmë Juridike Falas ia ka shpërndarë deputetëve. Ju rikujton përfaqësuesve të Agjencisë se jeni në Kuvend dhe ka disa çështje që janë shumë të ndjeshme, dhe këto mbishkrime nuk duhet figurojnë kështu në këto libra.

Halit Krasniqi, u pajtua që raporti të hiqet nga rendi ditës, kurse duke folur për librat – informatorët, ai tha se kjo është një arsye shtesë që t'i jepet një vërejtje se nuk duhet të ekzistojnë emetime në këta informator, që nuk njihen. Ky është shqetësim. Si ka guxim administrata e Komisionit për Ndihmë Juridike, të bëjë emërtime të tilla? Ju sugjeroj përfaqësuesve që të tërhiqeni me gjithë këto materiale nga mbledhja dhe në mbledhjen e radhës të vini ashtu si iu ka hije.

Albulena Haxhiu, duke u ndërlidhur me diskutimet e parafolësve, tha se jo vetëm në këto botime, por edhe në përmbajtjen e raportit vjetor të Agjencisë figuron “Kosova veriore – Mitrovicë “ dhe nuk e di ku e kanë marrë këtë shprehje. Propozoi që, jo vetëm botimet, por edhe raporti të tërhiqet, sepse ka të njëjtën shprehje dhe kjo për ne është e papranueshme, sepse Mitrovica është një dhe nuk ka veri – jug.

Armend Zemaj, tha se kjo mos të bëhet pjesë e debatit, sepse ka edhe gabime në përkthime. Ndoshta mund të jetë ndonjë gabim, kështu që në raportin e radhës t'i bëjnë përmirësimet e nevojshme dhe e shqyrtojmë në mbledhjen e radhës, pra mund t'i japin arsyetimet e nevojshme.

Kryetari, kërkoi nga përfaqësuesit e Agjencisë që ta tërheqin raportin, që të përfshihen vërejtjet nga kjo mbledhje dhe të sillet raporti tjetër për shqyrtim në një mbledhje të radhës.

Kryetari konstatoi se rendi i ditës u miratua me ndryshimet e propozuara.

2. Shqyrtimi i propozim-amendamenteve të grupit punues në Projektligjin për ekzekutimin e sanksioneve penale

Armend Zemaj, në cilësi të grupit punues, arsyetoi punën e grupit punues dhe arsyetoi amendamentet e propozuara. Ai tha se është një nga projektligjet që i kemi kushtuar vëmendje të veçantë, edhe pse e kemi mbajtur një kohë të gjatë në procedurë. Kemi bërë përpjekje të heqim dualizmat dhe kujdes të veçantë i është kushtuar përputhshmërisë me organizimin e ri të gjykatave, si dhe pajtueshmërisë me dispozitat e Kodit penal dhe Kodit të procedurës penale.

Meqë nuk kishte vërejtje në amendamentet e propozuara nga grupi punues, kryetari konstatoi se Komisioni, në mënyrë unanime, nxori këtë

Përfundim

Projektligji për ekzekutimin e sanksioneve penale dhe amendamentet e propozuara procedohen për shqyrtim të mëtejme në komisionet kryesore.

3. Shqyrtimi i raportit të Komisionit për Buxhet dhe Financa, lidhur me vendimin e presidentes së Republikës së Kosovës për kthimin e Ligjit nr. 04/L-163 për mallrat e liruar nga tatimi doganor dhe mallrat me tarifë zero të tatimit doganor

Kryetari, paraqiti për shqyrtim raportin e Komisionit për Buxhet dhe Financa, lidhur me vendimin e presidentes së Republikës së Kosovës për kthimin e Ligjit për mallrat e liruar nga tatimi doganor dhe mallrat me tarifë zero të tatimit doganor. Ai e vlerësoi të drejtë vendimin e presidentes për kthimin e ligjit, sepse neni 4 dhe amendamenti i propozuar, me të cilin përcaktohet ndryshimi i aneksit të Ligjit për mallrat e liruar nga tatimi doganor dhe mallrat me tarifë zero të tatimit doganor, pa u zbatuar procedura për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit, nuk ka bazë juridike për procedim të mëtejme.

Kryetari konstatoi se Komisioni për Legjislacion njëzëri nxori këtë

R e k o m a n d i m

1. Neni 4 dhe amendamenti i propozuar nga Komisioni për Buxhet dhe Financa, nuk ka bazë juridike për procedim të mëtejme.

4. Shqyrtimi i raportit plotësues të Komisionit për Buxhet dhe Financa në Projektligjin nr. 04/L-185 për tarifat e veçanta të akcizës për prodhimin fillestar dhe prodhimeve të produkteve alkoolike të prodhuara në Kosovë

Kryetari, tha se edhe te Projektligji për tarifat e veçanta të akcizës për prodhimin fillestar dhe prodhimeve të produkteve alkoolike të prodhuara në Kosovë, kemi të njëjtin problem, ku me amendamentin e propozuar të komisionit, përcaktohet ndryshimi i shtojcës A dhe B të ligjit, që po ashtu, nuk ka bazë juridike për procedim të mëtejme dhe është në kundërshtim me nenin 79, sepse ligji nuk mund të ndryshohet pa u zbatuar procedura për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit.

Kryetari konstatoi se Komisioni për Legjislacion njëzëri nxori këtë

R e k o m a n d i m

1. Neni 4 i Projektligjit dhe amendamenti i propozuar nga Komisioni për Buxhet dhe Financa, nuk ka bazë juridike për procedim të mëtejme.

5. Të ndryshme

a. Njoftim për skadimin e mandatit të anëtarëve të Këshillit Gjyqësor të Kosovës dhe Agjencisë Kosovare të Pronës

Kryetari, i njoftoi deputetët se anëtarëve të Këshillit Gjyqësor të Kosovës u ka skaduar mandati dhe është e nevojshme që të ndërmerren veprimet e nevojshme për të kërkuar nga grupet parlamentare, që në pajtim me nenin 108, par. 6, pika 2,3 dhe 4 e Kushtetutës, t'i propozojnë kandidatët për anëtarë të Këshillit Gjyqësor të Kosovës.

Po ashtu, edhe anëtarëve të Bordit mbikëqyrës të Agjencisë Kosovare të Pronës, u ka skaduar mandati i anëtarit të Bordit mbikëqyrës të Agjencisë.

Komisioni vlerësoi se, me qëllim të krijimit të kushteve që Kuvendi i Kosovës ta përmbushë obligimin ligjor për emërimin e anëtarëve, është e nevojshme që të ndërmerren veprimet e nevojshme për propozimin e anëtarëve nga institucionet përgjegjëse.

b. Monitorimi i Ligjit për Agjencinë kundër Korrupsionit

Kryetari, propozoi që të merret vendim për monitorimin e Ligjit për Agjencinë kundër Korrupsionit dhe të formohet një grup punues. Kjo edhe për një arsye shtesë që edhe vetë drejtori i Agjencisë në raportimin e tij para Komisionit, ka shprehur shqetësimin për nevojën e ndryshimeve ligjore.

Albulena Haxhiu, e vlerësoi të nevojshme mbikëqyrjen e këtij ligji. Ajo tha se ne kemi përgjegjësi ligjore që ta mbikëqyrim këtë Agjenci. Po ashtu, ajo kërkoi që Komisioni të kërkojë

nga Agjencia, që zyrtarët e Agjencisë t'i sjellin formularët e deklarimit të pasurisë. Kurse sa i përket grupit punues, ishte e mendimit që nga secili subjekt parlamentar të jetë nga një anëtar.

Kryetari konstatoi se Komisioni për Legjislacion njëzëri nxori këtë

P ë r f u n d i m

1. Formohet Grupi i punës për mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për Agjencinë kundër Korrupsionit, në përbërje:

Arben Gashi – kryesues

Armend Zemaj – anëtar

Jasmina Zhivković – anëtare

Albulena Haxhiu – anëtare

Gëzim Kelmendi - anëtar

Mbledhja përfundoi në orën 12:50.

Kryetari i Komisionit

E përgatiti:

Stafi Mbështetës i Komisionit.

Arben Gashi